



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 189 Prot.

Lezhë, më 08/01 /2026

NJOFTIM

**“PËR
ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E PLANIT
VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2026-2030”**

Në mbështetje të ligjit Nr. 8417., datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, ligji Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji Nr. 119/2015 “Për të drejtën e informimit”, ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Vendim Nr. 88., datë 22.02.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim europian 2022-2030”, Vendim Nr. 271., datë 02.05.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për migracionin 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit 2024-2026”, Vendim Nr. 173., datë 24.03.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030”, Vendim Nr. 621., datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, si dhe Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030”;

Bashkia Lezhë ka përgatitur Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030, një dokument strategjik i rëndësishëm, qëllimi i planit është të ndërtojë një infrastrukturë të përshtatshme për të menaxhuar me efikasitet dhe koordinimin e çështjeve të migracionit dhe diasporën duke i bërë ata faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik lokal.

Ky dokument është hartuar nga Bashkia e Lezhës, në kuadër të Programit të GIZ (MEG) “Fuqizimi i Politikave për Orientimin e Migracionit drejt Zhvillimit”, i mbështetur financiarisht nga Qeveria Gjermane.

Për të siguruar që ky plan reflekton nevojat dhe shqetësimet tuaja, po bëjmë ndarjen e tij për konsultim publik. Kjo është një mundësi për ju që të ndani mendimet, sugjerimet, propozimet tuaja duke kontribuar drejtpërdrejtë në krijimin e një plani që shërben për interesat e të gjithëve.

Ne ju inkurajojmë të merrni pjesë aktivisht në këtë proces dhe të bëheni pjesë e zgjidhjeve për një komunitet më të fortë dhe solidar.

Me datë 12 Shkurt 2026, ora 13:00, në ambjentet e Bibliotekës “Gjergj Fishta” të qytetit ,
kati i II-të.

Draft Plani Vendor i Veprimit për Migracioni dhe Diasporën 2026-2030.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Reinis Çela

